



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.57/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti-kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi-anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, të parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, të datës 29.12.2025, parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës,, të datës 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 29.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se më datë 28 dhjetor 2025, në ditën e votimit kandidatë për deputet nga radhët e Subjektit Politik PREBK, Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo, kanë ushtruar ndikim në orientimin e votuesve, duke thyer heshtjen zgjedhore dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Si provë në ankesa parashtruesi i ankesave ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigje në ankesë të Subjekti Politik PREBK, theksojnë se pretendimet e Subjektit Politik LPRK, janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe prova.

Në përgjigjen ZP.Anr.57/2025 dhe ZP.Anr.58/2025 se gjoja se z. Gjonejt Kallo dhe Qamil Avdo, ish kandidatë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 09 shkurt 2025, kanë ushtruar ndikim dhe ndihmë në orientimin e votues, është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar në ligj dhe Rregulloret Zgjedhure të KQZ-së, sepse ndalja në rrugë dhe komunikimi me familjar dhe miq, nuk do të thotë që automatikisht ka shkelje të heshtjes zgjedhore dhe ushtrim ndikimi. Prandaj përmes kësaj përgjigje kërkojnë nga PZAP-ja që ta hedhë si ta pabazuar në prova, ankesën e subjekti politik LPRK.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, të datës 29.12.2025, të paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) kundër Subjektit Politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me numrat e ankesave si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZP.A.nr.57/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë, vëren se ankesat janë të pabazuara.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndëve, përkatësisht ankesave ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, si dhe pas vlerësimit të provave të bashkëngjitura në ankesa dhe përgjigjeve në ankesa, PZAP vlerëson se pretendimet e subjektit politik LPRK janë të pabazuara.

Parashtruesi i ankesës Subjekti Politik LPRK në ankesat e saj ka theksuar se kandidatë për anëtarë të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e Subjektit Politik PREBK, Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo, kanë ushtruar ndikim në orientimin e votuesve, duke thyer heshtjen zgjedhore dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe provat e bashkangjitura, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave të LZP-së, përkatësisht, nenit 37 që i referohet Veprimeve të Ndaluara Para Procesit të Votimit, përkatësisht paragrafi 1, i cili përcakton se *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.”* Sepse nga shikimi i fotove të bashkangjitura ankesave vërehet komunikimi i kandidatëve me disa persona, por nuk mund të vërtetohet vendi ku është bërë ky komunikim dhe për çfarë kanë komunikuar me qytetar, e rrjedhimisht nga kjo, paneli vlerëson se nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, se ka pasur ndikim në vullnetin e qytetarëve për të votuar, nga ana e kandidatit Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo.

Duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lart, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë

të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.57/2025 më datën 31.12.2025

Kryesues i Panelit,
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.1/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Delushe Halimi dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, kundër subjektit politik, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.57/2025, të datës 31.12.2025, në seancën e mbajtur më datë 05.01.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e subjektit politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP. Anr.57/2025, i datës 31.12.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.57/2025, të datës 31.12.2025, ka vendosur: Refuzohen si të pabazuara ankesat e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, të datës 29.12.2025, të parashtruara kundër subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta shfuqizojë vendimin e PZAP-it, ZP.A nr.57/2025, dhe të urdhërojë anulimin e votave në Qendrën e Votimit - Gjinnazi "Gjon Buzuku", Prizren dhe për subjektin politik PREBK të shqiptojë masat ndëshkuese të parapara me ligj ndaj subjektit politik PREBK dhe kandidatëve përgjegjës.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi ZP. Anr.57/2025, i datës 31.12.2025, të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.12.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, nga subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, në të cilën pretendohet se më datë 28 dhjetor 2025, në ditën e votimit kandidatë për deputet nga radhët e subjektit politik PREBK, Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo, kanë ushtruar ndikim në orientimin e votuesve, duke thyer heshtjen zgjedhore dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), më datë 30.12.2025, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën i ka kundërshtuar në tërësi ankesat e subjektit politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), me propozim që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.57/2025, të datës 31.12.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e subjektit politik, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK), duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: pas shqyrtimit të shkresave të lëndëve, përkatësisht ankesave ZP.Anr.57/2025, dhe ZP.Anr.58/2025, si dhe pas vlerësimit të provave të bashkëngjitura në ankesa dhe përgjigjeve në ankesa, PZAP vlerëson se pretendimet e subjektit politik LPRK janë të pabazuara.

Ka shtuar se parashtuesi i ankesës subjekti politik LPRK në ankesat e saj ka theksuar se kandidatë për anëtarë të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e subjektit politik PREBK, Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo, kanë ushtruar ndikim në orientimin e votuesve, duke thyer heshtjen zgjedhore dhe duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe provat e bashkëngjitura, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave të LZP-së, përkatësisht, nenit 37 që i referohet Veprimeve të Ndaluara Para Procesit të Votimit, përkatësisht paragrafi 1, i cili përcakton se: “Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”. Sepse nga shikimi i fotove të bashkëngjitura ankesave vërehet komunikimi i kandidatëve me disa persona, por nuk mund të vërtetohet vendi ku është bërë ky komunikim dhe për çfarë kanë komunikuar me qytetar, e



rrjedhimisht nga kjo, paneli vlerëson se nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, se ka pasur ndikim në vullnetin e qytetarëve për të votuar, nga ana e kandidatit Gjynejt Kallo dhe ish kandidati Qamil Avdo.

Duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lart, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së subjektit politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK) me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 28 Dhjetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova të mjaftueshme që do të vërtetonte faktin se subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, e paraparë në nenin 37 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, dhe përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike ashtu si thekson parashtuesi i ankesës dhe se këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sepse PZAP vendimin e saj e bazon mbi faktin se ankuesi nuk ka ofruar prova të qarta se kemi të bëjmë me shkelje të kodit të mirësjelljes.

Vendimi i kundërshtuara nuk është i përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 37 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: *"1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit, 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre"*.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nga dispozita ligjore e lartcekur dhe në bazë të analizës së provave të paraqitura dhe rrethanave faktike të rastit konkret, rezulton se pretendimet e ankuesit lidhur me ekzistencën e shkeljes së heshtjes zgjedhore dhe të Kodit të Mirësjelljes nuk qëndrojnë. Fotot e ofruara si dëshmi nuk arrijnë të provojnë në mënyrë të qartë dhe të padiskutueshme se veprimet e personave të paraqitur në to përbëjnë ndikim, presion apo orientim të votuesve në lidhje me ushtrimin e së drejtës së votës. Po ashtu, nga përmbajtja e këtyre fotove nuk mund të konstatohet me saktësi vendndodhja e personave në raport me



qendrën e votimit, pasi mungojnë elemente identifikuese që të dëshmojnë distancën e tyre reale nga vendvotimi, ashtu siç kërkohet nga dispozitat përkatëse ligjore. Në mungesë të këtyre elementeve thelbësore, nuk plotësohen kriteret ligjore për të konstatuar se kemi të bëjmë me shkelje të heshtjes zgjedhore apo të Kodit të Mirësjelljes. Për rrjedhojë, pretendimet e ankuesit mbeten të pabazuara në prova konkrete dhe bindëse, duke mos krijuar një bazë të mjaftueshme faktike dhe juridike për pranimin e ankesës.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit të mirësjelljes, përkatësisht heshtjes zgjedhore, u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 37, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.1/2026, datë 05.01.2026.

Kryetarja e kolegjit,
Franciska Zhitija – Ymeri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik